



# Beyond the Doorstep

Projekt nr.101093772  
Erasmus-Youth-2022-CB

## Qëllimi ynë

Në Japoni dhe së fundmi edhe në vendet perëndimore, ne jemi dëshmitarë të rritjes së numrit të të rinjve, veçanërisht adoleshentëve të cilët zgjedhin vullnetarisht të tërhiqen nga shoqëria, duke ndërprerë marrëdhëniet shoqërore. Ky fenomen njihet ndërkombëtarisht si Hikikomori (nga japonishtja 'vetë - izolim').

Niveli i ndërgjegjësimit mbi fenomenin dhe analiza e situatës në vendet partnere në projekt nxorri në pah disa probleme, që nga mungesa e studimeve deri tek informacionet çorientuese në media, të cilat shpeshherë e barazojnë fenomenin me një varësi të thjeshtë ndaj internetit dhe video-lojërave. Projekti "Beyond the Doorstep" synon të rrisë ndërgjegjësimin dhe të punojë për parandalimin e fenomenit Hikikomori në katër vendet e përfshira (Itali, Bosnje dhe Hercegovinë, Shqipëri dhe Turqi). Palët e interesuara, organizatat dhe institucionet që punojnë për këtë çështje do të pasurojnë njohuritë dhe do të paraqesin studime të rasteve dhe praktika të mira, të cilat do të përmbledhen në një dokument (Toolkit) të aksesueshëm nga publiku dhe do të jetë një burim i hapur edukativ, i përkthyer në të gjitha gjuhët e vendeve të përfshira në projekt.

Konkretisht, partnerët do të punojnë për të arritur objektivat e mëposhtëm:

- Rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve, familjeve, organizatave rinore, shkollave dhe institucioneve mbi fenomenin e Hikikomorit, duke përcjellë informacione korrekte mbi fenomenin, shkaqet dhe dinamikën e mundshme;

- Trajnimi i punonjësve rinorë, profesionistëve të fushës dhe mësuesve për të punuar në parandalimin dhe identifikimin e shenjave të para të tërheqjes sociale, duke ofruar njohuri, teknika dhe materiale për veprimtarinë e tyre lokale;

- Krijimi i një rrjeti në nivel lokal dhe ndërkombëtar për të promovuar njohjen e Hikikomorit dhe integrimin e tij në politikat lokale dhe kombëtare;

- Të kontribuojë në zbatimin e strategjisë dhe objektivave të BE-së për të rinjtë dhe të mbështesë zhvillimin e punës rinore, veçanërisht në vendet partnere.

## Rezultatet

Me aktivitetet dhe rezultatet e parashikuara, projekti "Beyond the doorstep" synon të nxisë diskutime dhe reflektime mbi temën e Hikikomorit në vendet e përfshira, duke bërë të mundur shkëmbimin e metodave, njohurive, rasteve konkrete dhe praktikave më të mira midis vendeve që kanë eksperiencë në njohjen e fenomenit, tek vendet e tjera në të cilat nuk njihet dhe nuk është studiuar ende ky fenomen.

Jashtë kontekstit japonez, nuk është zhvilluar ende një literaturë e njëtrajtshme mbi fenomenin, për këtë arsye është thelbësore të nxiten aktivitete parandalimi dhe ndërgjegjësimi mbi këtë temë. Ky fenomen duhet të njihet si fenomen më vete, i shkëputur nga patologji të tjera të shëndetit mendor që rrjedhin apo nga dinamika të ndryshme.

Të flasësh për fenomenin Hikikomori është thelbësore, si midis edukatorëve, mësuesve dhe punonjësve rinorë që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë, edhe midis të rinjve që mund të njohin karakteristikat Hikikomori tek bashkëmoshatarët e tyre ose tek vetja e tyre.

Nëpërmjet metodave joformale si workshops ndërkombëtare, laboratorë lokal me studentë dhe trajnimit të trajnerëve me edukatorë, mësues, punonjës rinorë dhe ekspertë, konsortiumi synon të punojë në parandalimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit dhe në pasqyrimin korrekt të fenomenit Hikikomori.

## Çfarë ka ndodhur deri tani?

Konsortiumi i projektit "Beyond the Doorstep" është formuar nga partnerët si në vijim: YouNet APS nga Italia si koordinatori të projektit, People in Focus (Shqipëri), Istanbul Aile, Calisma ve Sosyal Hizmetler İl Mudurlugu (Turqi), Udruzenje za Zastitu Mentalnog Zdravlja Menssana (Bosnje-Hercegovinë) dhe mbështetet nga Komisioni Evropian përmes Agjencisë Ekzekutive për Arsimin, Kulturën, Mediat Audiovizuale (EACEA). Projekti zbatohet nga data 01.12.2022 deri më 30.11.2024.

Takimi i parë ndërkombëtar u zhvillua nga data 23 deri më 24 maj 2023 në Tiranë, Shqipëri. Gjatë takimit, ne eksploruam fenomenin Hikikomori me trajneren e talentuar, Doktoreshën Rosanna D'Onofrio nga shoqata Italiane e Hikikomorit. Ajo paraqiti një pasqyrë shumë të përgjithshme të fenomenit për ta kuptuar më mirë atë dhe në mënyrë që të vendoseshin themelet e para të njohurive për tu përgatitur për takimet e ardhshme ndërkombëtare.

Takimi i dytë ndërkombëtar u mbajt nga 25 deri më 26 korrik 2023 në Stamboll, Turqi. Gjatë këtij takimi të dytë, partneriteti pati mundësinë të thellohet më tej mbi temën e Hikikomorit, duke u fokusuar veçanërisht në mjedisin që rrethon personin e prekur nga Hikikomori, përkatësisht shkollat dhe mësuesit. Ky takim u drejtua nga doktoresha Maria Laura Trifilò nga shoqata Italiane e Hikikomorit.

Për më shumë informacion mbi projektin "Beyond the Doorstep", vizitoni faqen e internetit të projektit dhe llogaritë tona në rrjetet sociale.

## Partnerët në Projekt



YouNet Association  
(Italy, Coordinator)  
info@you-net.eu



People in Focus  
(Albania)  
peopleinfocusalbania@gmail.com



IFSS  
(Turkey)  
merve.simsek.ifss@gmail.com



Menssana  
(Bosnia-Herzegovina)  
ornelacolic@gmail.com



## Çfarë do të ndodhë më pas?

- Takimi i tretë ndërkombëtar në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë do të zhvillohet në shtator 2023.
- Takimi i katërt ndërkombëtar në Reggio Emilia, Itali do të zhvillohet në tetor 2023.
- Vazhdimi i punës për përpilimin e Toolkit dhe burimit të hapur edukativ.



<https://beyondthedoortstep.weebly.com/>



Beyond the doorstep



info@you-net.eu